

Mbështetja e USAID-it ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit, ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve

Tribuna

Prishtinë, 2 nëntor

Me mbështetjen e USAID-it janë pulsuar 75 studentët të universiteteve të Kosovës, të cilët kanë ndjekur trajnime dhe programe të praktikës. Drejtor i KPEP-it, Mark Wood, ka thënë se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës. "Për t'u ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për

USAID NDIHMOM TË RINJË PËR PUNËSIM PROFESIONAL

USAID-i ka punësuar dhjetëra të rinj

Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës", ka thënë Wood. Sipas tij, trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

Punësim në institucione të ndryshme

Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga "World University Service" - Austria (WUS-Austria), kanë përfituar 40 studentë, të cilët janë vendosur në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë ko-



munave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent. Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestarë dhe 5 mentorë, të cilët

ishin zgjedhur nga pilot grupi i programit të vitit 2009. Programi papë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar. Po ashtu ka pasur edhe programe dhe trajnime të tjera.

03/11/2010, "TRIBUNA SHQIPTARE"